452 13.04.23

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

Nr. 1514 Prot

Peshkopi, më 13.04.2023

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr.46**

**Datë: 07.04.2023**

**"Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026"**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Afrim Mikli**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel. 0035521822935

BASHKIA PESHKOPI
Nr. 1514/1
Data 28/04/23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT DIBËR**

Nr. 452/1.prot.

Peshkopi, më 14.04.2023

Lënda : Per vendimin nr. 46, datë 07.04.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.46, date 07.04.2023 "Për miratimin e tavaneve pergaditore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026", vendosa:

Të miratojë në parim vendimin objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e finances e probleme të ngjashme me to, veprime që kurdoherë ngarkojnë me përgjegjësi direkte administrativo-ligjore strukturat e posaçme të Bashkisë Dibër që kanë paraqitur për miratim projekt aktin mbi bazën e të cilit ka dale vendimi nr.46, datë 07.04.2023.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU

*Adresa : Bulevardi "Elez ISUFI" Peshkopi, Albania, Tel. 00355 218 2- 2082,Tel 00355 218 2– 2631, E-mail prefekturadiber@gmail.com*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

# VENDIM

Nr 46 Datë 07/04/2023

**"Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026"**

Mbështetur në nenin 9 pika 1.3, nenin 34, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 34 të ligjit nr.68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"i ndryshuar dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.6 datë 28.02.2023 "Për përgatitjen Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026":, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **07.04.2023** me 19 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

**VENDOSI:**

I. Të miratojë tavanet përgatitore të shpenzimeve te programit buxhetor afatmesem për vitet 2024 - 2026, te Bashkisë se Dibër, sipas tabelës (D1) tavanet e PBA 2024-2026, pjesë përbërese e Instrumentit të Planifikimit Financiar (FPT).

II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjithë drejtoritë dhe sektorët e institucionit të Bashkise Dibër.

III. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

IV. Vendimi u shpall me datë **07.04.2023**.

**Kryetar Këshilli**

**Sokol Sava**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

*Adresa:Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi,nr.tel.&fax. 00355 218 229 37 e-mail: bashkiadiber@gmail.com*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR**
**DREJTORIA EKONOMIKE**
**Sektori i Financës**

# PROJEKT-VENDIM

**Nr. 07 Datë 31/03/2023**

**"Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026"**

Mbështetur në nenin 9 pika 1.3, nenin 34, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 34 të ligjit nr.68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"i ndryshuar dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.6 datë 28.02.2023 "Për përgatitjen Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026":

Kërkojmë:

1. Të miratojë tavanet përgatitore të shpenzimeve te programit buxhetor afatmesem për vitet 2024 - 2026, te Bashkisë se Diber, sipas tabelës (D1) tavanet e PBA 2024-2026, pjesë përbërese e Instrumentit të Planifikimit Financiar (FPT).

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjithë drejtoritë dhe sektorët e institucionit të Bashkise Dibër.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

**PËR BASHKINË DIBËR:**

Përgjegjës Sektori Juridik
Elona LUSHA

Përgjegjëse Finance
Antike TORBA

Drejtor Ekonomik
Mensur SHEHI

**KRYETARI**

**Rahim SPAHIU**

**Në mungesë dhe me urdhër**

**Zv.Kryetari**

**Ruzhdi DEDA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA DIBËR

*Adresa:Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi,nr.tel.& fax. 00355 218 22937 e-mail: bashkiadiber@gmail.com*

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës

# (D1) TAVANET

| | | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| | | Viti t+1 (I pritur) | Viti t+2 (I pritur) | Viti t+3 (I pritur |
| **01110** | **Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 137,533 | 137,533 | 137,53 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 63,640 | 63,640 | 63,64 |
| Shpenzimet kapitale | | 4,000 | 4,000 | 4,00 |
| **Tavanet e përgjithshme** | | 205,173 | 205,173 | 205,17 |
| **03140** | **Shërbimet e Policisë Vendore** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 7,350 | 7,350 | 7,35 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 350 | 350 | 35 |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | |
| **Tavanet e përgjithshme** | | 7,700 | 7,700 | 7,70 |
| **03280** | **Mbrotja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 25,851 | 25,851 | 25,85 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 13,596 | 13,596 | 13,59 |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | [illegible] |
| **Tavanet e përgjithshme** | | 39,447 | 39,447 | 39,44 |
| **04130** | **Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 1,551 | 1,551 | 1,551 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 80 | 80 | 8 |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | [illegible] |
| **Tavanet e përgjithshme** | | 1,631 | 1,631 | 1,631 |
| **04220** | **Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | | |
| Të tjera shpenzime korrente | | | | |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e përgjithshme** | | | | |
| **04240** | **Menaxhimi i Infrastruktuës së Ujitjes dhe Kullimit** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 3,100 | 3,100 | 3,100 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 170 | 170 | 170 |
| Shpenzimet kapitale | | 21,132 | 18,132 | 20,132 |
| **Tavanet e përgjithshme** | | 24,402 | 21,402 | 23,402 |
| **04260** | **Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 8,379 | 8,379 | 8,379 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 745 | 745 | 745 |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e përgjithshme** | | 9,124 | 9,124 | 9,124 |
| **04520** | **Rrjeti Rrugor Rural** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | | |
| Të tjera shpenzime korrente | | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzimet kapitale | | 181,249 | 209,640 | 237,623 |
| **Tavanet e përgjithshme** | | 181,249 | 209,640 | 237,623 |
| **04570** | **Transporti Publik** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | | |

Copyright for Albania: Ministry of Finance and Economy / Local Finance Directory

| | | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| | | Viti t+1 (I pritur) | Viti t+2 (I pritur) | Viti t+3 (I pritur) |
| Të tjera shpenzime korrente | | | | |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | | | |
| **05100** | **Menaxhimi i Mbetjeve** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 22,600 | 22,600 | 22,600 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 1,010 | 1,010 | 1,010 |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | 23,610 | 23,610 | 23,610 |
| **06140** | **Planifikimi Urban Vendor** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 380 | 380 | 380 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 120 | 120 | 120 |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | 500 | 500 | 500 |
| **06260** | **Shërbimet Publike Vendore** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 82,100 | 82,100 | 82,100 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 73,153 | 73,153 | 73,153 |
| Shpenzimet kapitale | | 21,818 | 21,818 | 21,818 |
| Tavanet e përgjithshme | | 177,071 | 177,071 | 177,071 |
| **06370** | **Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | | |
| Të tjera shpenzime korrente | | | | |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | | | |
| **07220** | **Shërbimet e Kujdesit Parësor** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 13,980 | 13,980 | 13,980 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 10,550 | 10,550 | 10,550 |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | 24,530 | 24,530 | 24,530 |
| **08130** | **Sport dhe Argëtim** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 9,776 | 9,776 | 9,776 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 27,224 | 27,224 | 27,224 |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | 37,000 | 37,000 | 37,000 |
| **08220** | **Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 17,320 | 17,320 | 17,320 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 6,000 | 6,000 | 6,000 |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | 0 |
| Tavanet e përgjithshme | | 23,320 | 23,320 | 23,320 |
| **09120** | **Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 140,438 | 140,438 | 140,438 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 14,307 | 14,307 | 14,307 |
| Shpenzimet kapitale | | 2,860 | 2,860 | 2,860 |
| Tavanet e përgjithshme | | 157,605 | 157,605 | 157,605 |
| **09230** | **Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | 33,608 | 33,608 | 33,608 |
| Të tjera shpenzime korrente | | 14,024 | 14,024 | 14,024 |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | 0 | 0 |

Copyright for Albania: Ministry of Finance and Economy / Local Finance Directory

| | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|
| | Viti t+1 (I pritur) | Viti t+2 (I pritur) | Viti t+3 (I pritur) |
| **Tavanet e përgjithshme** | 47,632 | 47,632 | 47,632 |
| **10430 Përkujdesi Social** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | 18,200 | 18,200 | 18,500 |
| Të tjera shpenzime korrente | 3,500 | 3,500 | 3,700 |
| Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e përgjithshme** | 21,700 | 21,700 | 22,200 |
| **10661 Strehimi Social** | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | 319 | 319 | 319 |
| Të tjera shpenzime korrente | 3,200 | 3,200 | 3,200 |
| Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e përgjithshme** | 3,519 | 3,519 | 3,519 |
| | | | |
| TOTALI PAGAVE DHE SIGURIMEVE SHOQËRORE | 522,485 | 522,485 | 522,785 |
| TOTALI I SHPENZIMEVE TË TJERA KORRENTE | 231,669 | 231,669 | 231,869 |
| TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE | 231,059 | 256,450 | 286,433 |
| **TOTALI I TAVANEVE TË PËRGJITHSHME** | 985,213 | 1,010,604 | 1,041,087 |

Drejtori Ekonomik

Mensur Shehi

Copyright for Albania: Ministry of Finance and Economy / Local Finance Directory

**SHTOJCA 2**

**Relacioni i përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm vendor, 2024-2026**

# Bashkia Diber

**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM**
**2024 – 2026**
**TAVANET PERGATITORE TE PROGRAMIT BUXHETOR AFAT MESEM VENDOR 2024-2026**

## 1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, shpagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burimet midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat për të cilat do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllimet strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, ndihmon në ruajtjen e disiplinës financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve e objektivave të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor ndihmojnë gjatë e ardhmen njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara të demografisë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion, në të ardhmen, u mundëson njësive

vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve)

Bazuar ne udhezimet e MFE dhe udhëzimin e brendshem te NJVQV per pergaditjen e PBA vendor 2024-2026, plani strategjik i zhvillimit/plani i pergjithshem vendor ( i territorit , plani social, plani i zhvillimit ekonomik, plani per mbrojtjen e mjedisit) te Njesise se Veteqeverisjes vendore. Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal, etj. Tavanet e Pergatitjes se PBA Vendore 2024-2026, nje hap i rendesishem per te garantuar qe procesi i planifikimit te shpenzimeve te programit te jene ne perputhje me parashikimin e te ardhurave, stabilitetin fiskal si dhe prioritetet strategjike te NJVQV-se, eshte vendosja e tavaneve te shpenzimeve. Nje "tavan" ne kete kontekst eshte kufiri i siperm i shumes totale te parave qe mund te shpenzohen ose te planifikohen per tu shpenzuar per nje qellim te caktuar. Me alokimin e Tavaneve te Pergatitjes se PBA-se Vendore 2024-2026 per programet buxhetore , Keshilli i NJVQV-se garanton qe shpenzimet te planifikohen ne menyre qe te buxhetojne politikat,prioritetet, objektivat strategjike te NJVQV-se dhe te jene ne perputhje me alokimin startegjik te burimeve.

Drejtori Ekonomik
Mensur SHEHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

# KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga P.Q. Dibër dhe mban nga dërguesi nr 452/1 prot datë 17.04.2023 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes( lënda)________________

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr.hyrës prot 1514/1 datë 18.04.2023.

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z________________

-Znj/Z Sekretarit të Këshillit Bashkiak

-Znj/Z________________

-Znj/Z________________

me porosinë: Administrohet praktika sipas ligjit

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore( përgjigjes,..etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë sipas afatve

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:________________

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

Peshkopi, më 18.04.2023

________________